



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr.19, datë 29.3.2017

Për

MIRATIMIN E DOKUMENTIT “KODI I PRAKTIKAVE PËR STATISTIKAT NË BANKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat “c” dhe “g” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin “Kodi i praktikave për statistikat në Bankën e Shqipërisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Statistikave Financiare dhe të gjitha njësitë e tjera organizative të Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi dhe të dokumentit bashkëlidhur në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Elvis ÇIBUKU

KRYETARI

Gent SEJKO

Dokumenti

“Kodi i praktikave për statistikat në Bankën e Shqipërisë”

I. Qëllimi i Kodit

Ky kod ka për qëllim të përcaktojë standardet për mbledhjen, hartimin dhe shpërndarjen e produktit statistikor të Bankës së Shqipërisë (referuar në vijim si Banka) në përputhje me praktikatat më të mira¹.

Kodi do t'u vijë në ndihmë përdoruesve të informacionit statistikor, furnizuesve të të dhënave dhe prodhuesve të produkteve statistikore. Kodi siguron barazi dhe paanshmëri në trajtimin e njëjësive raportuese (furnizuesit e të dhënave) dhe shërben si udhëzues për punonjësit e Bankës të përfshirë në zhvillimin dhe shpërndarjen e statistikave.

II. Parimet bazë për rregullimin e procesit statistikor në Bankën e Shqipërisë

Banka në kuadër të hartimit dhe shpërndarjes së produktit statistikor synon të ndjekë parimet e mëposhtme:

1 Rëndësia

Statistikat e përgatitura prej Bankës duhet të sigurojnë informacion cilësor për të mbështetur vendimmarrjen e Bankës, të qeverisë, të bizneseve dhe të aktorëve të tjerë të interesit apo të komunitetit në tërësi. Në të njëjtën kohë, ato ndihmojnë në përmbushjen e funksionit llogaridhënës të Bankës.

Statistikat marrin vlerë për aq kohë sa i përgjigjen kërkesave të përdoruesve. Qëllimi i këtij seksioni është garantimi i shfrytëzimit efikas dhe eficient të burimeve kapitale dhe njerëzore për prodhimin e informacionit statistikor në përputhje me kërkesat e përdoruesve dhe në formën më të përshtatshme për ta. Banka synon të identifikojë nevojat e përdoruesve të statistikave, hendekun në informacionin statistikor si edhe përdorimin efektiv të burimeve njerëzore dhe kapitale.

Kodi parashtron përgjegjësinë e Bankës për informacion statistikor në kuadër të politikës monetare, mbikëqyrjes bankare dhe stabilitetit financiar duke i dhënë përparësi përdoruesve të statistikave në fushat e lartpërmendura. Pavarësisht kësaj, Banka realizon publikimin e treguesve të tjerë (të tillë si, sistemet dhe instrumentet e pagesave etj.). Banka harton dhe publikon një gamë të gjerë treguesish, nga kompetenca e saj ligjore, që ndikojnë sektorin real dhe atë financiar. Të dhënat statistikore përveçse të vlefshme për vendimmarrjen e Bankës janë po kaq të rëndësishme edhe në përmbushjen e përgjegjësisive publike të Bankës.

¹ Bazuar në konsultimet e literaturave të ndryshme, të pranuarra gjerësisht, si Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare të Komisionit Evropian dhe Komisionit të Statistikave të Kombeve të Bashkuara si dhe Kodit të Standardeve të Statistikave Evropiane, etj.

1.1 Prodhuesit e statistikave në Bankën e Shqipërisë kanë një marrëdhënie të veçantë me përdoruesit kryesorë si brenda Bankës ashtu dhe me agjenci të tjera publike përrshirë dhe Institutin e Statistikave. Këto marrëdhënie do të administrohen në mënyrë të tillë që të minimizojnë disavantazhet për përdoruesit e tjerë.

1.1.1 Informacioni statistikor për Komitetin e Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare (KZKPM) si edhe për përdoruesit e tjerë brenda Bankës, të cilët angazhohen në kërkime dhe analiza me qëllim bashkëpunimin me këtë Komitet, nxit një gamë të gjerë të kërkesave teknike dhe analitike për punonjësin e statistikës.

- Kërkesat për informacion statistikor nga anëtarët e KZKPM dhe stafi mbështetës përcillen përmes dhe adresohen nga Sektori i Statistikave Monetare dhe Financiare, për të mënjanuar punën e dyfishtë.

1.1.2 Informacioni statistikor për Komitetin për Stabilitetin Financiar (KSF), përbën një tjetër detyrim për plotësimin e kërkesave teknike dhe analitike për punonjësin e statistikës.

- Kërkesat për informacion statistikor nga anëtarët e KSF dhe stafi mbështetës kanalizohen nëpërmjet dhe adresohen nga Sektori i Përpunimit të Informacionit, për të mënjanuar punën e dyfishtë.

1.1.3 Banka bashkëpunon ngushtë me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

- Shkëmbimi i informacionit statistikor ndërmjet Bankës dhe AMF-së dakordësohet në Memorandumin e Mirëkuptimit, ose në të tjera marrëveshje plotësuese në rastet kur gjykohet e domosdoshme.

1.1.4 Banka bashkëpunon ngushtë me Institutin e Statistikave (INSTAT) pasi produktet statistikore të saj shërbejnë si kontribut i rëndësishëm për hartimin e statistikave të llogarive kombëtare.

- Bashkëpunimi i INSTAT me Bankën rregullohet me Memorandumin e Mirëkuptimit, i cili mbulon furnizimin me të dhëna, interpretimin e të dhënave, monitorimin e cilësisë dhe zhvillimin e serive të reja statistikore.
- Memorandumi i Mirëkuptimit është i disponueshëm në faqen zyrtare të Bankës www.bankofalbania.org

1.1.5 Banka bashkëpunon ngushtë edhe me organizma evropianë dhe institucione ndërkombëtare në fusha të interesave të përbashkëta.

- Departamenti i Statistikave Financiare raporton informacione statistikore pranë Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, në përputhje me vendimin për anëtarësimin e Bankës së Shqipërisë në Standardin e Përgjithshëm të Shpërndarjes së të Dhënave (GDDS).
- Departamenti i Statistikave Financiare raporton informacione statistikore pranë Eurostat dhe Bankës Qendrore Evropiane (BQE) në kuadër të protokolleve të përcaktuara në vijim të procesit të integritimit të vendit në Bashkimin Evropian.
- Punonjësit e Departamentit të Statistikave Financiare marrin pjesë në komitete të ndryshme të Eurostat dhe BQE.

1.1.6 Banka shpërndan statistikatat e prodhuara përmes internetit me qëllim që të sigurojë akses të njëjtë informacioni për të gjithë përdoruesit e statistikave.

1.1.7 Departamenti i Statistikave Financiare nxit interesin e publikut të gjerë në drejtim të produkteve statistikore:

- duke garantuar marrjen në konsideratë të interesave të të gjithë grupeve të përdoruesve, me synim trajtimin e barabartë të tyre;
- duke organizuar seminare me fokus teknik për grupet e gazetarëve me formim ekonomik në bashkëpunim me Zyrën e Shtypit të Bankës; dhe
- duke i dhënë përparësi internetit në shpërndarjen e informacionit statistikor, për të promovuar barazinë e të drejtave në marrjen e informacionit.

1.2 Përshtatshmëria e statistikave ekzistuese me nevojat e përdoruesve do të monitorohet duke identifikuar diferencat materiale.

1.2.1 Punonjësit e Departamentit të Statistikave Financiare zotërojnë plotësisht përkufizimet rregullatore që përshkruajnë çdo produkt specifik statistikor. Ata duhet të studiojnë dhe të rrisin shkallën e kuptimit edhe për kërkesat specifike të përdoruesve.

- Punonjësit e Departamentit të Statistikave mbështesin Departamentet e Politikës Monetare dhe Stabilitetit Financiar në interpretimin metodologjik të të dhënave, si dhe marrin pjesë në prezantimet e analizave të këtyre të fundit në Bankë.
- Punonjësit e Departamentit të Statistikave monitorojnë dhe marrin në konsideratë interpretimet e shtypit në lidhje me statistikat e Bankës.

1.2.2 Departamenti i Statistikave Financiare mban një historik të përdoruesve të cilët vizitojnë seksionin Statistika në faqen zyrtare të Bankës si edhe të përdoruesve të tjerë të cilët ndërveprojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me njësinë përkatëse në Departament, duke identifikuar dhe dokumentuar kërkesat e reja të përdoruesve.

- Adresa elektronike e njësisë përgjegjëse për përgatitjen e informacionit statistikor është në dispozicion të publikut.

1.3 Planifikimi i ndryshimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me mbledhjen, metodologjitë e hartimit ose karakteristikat tjera të produkteve statistikore, bëhet duke tërhequr paraprakisht mendimin e përdoruesve.

1.3.1 Planet për prezantimin, ndryshimin ose ndërprerjen e prodhimit të statistikave do të marrin në konsideratë mendimin e përdoruesve, raportuesve të të dhënave dhe të ekspertëve të fushës.

- Konsultimet do të fokusohen në përdoruesit e rëndësishëm të cilët kanë interes në çështjen në fjalë.

1.3.2 Thellësia dhe kohëzgjatja e konsultimeve do të kryhet në një nivel të përshtatshëm me rëndësinë e çështjes.

1.3.3 Konsultimet zyrtare do të jenë transparente dhe përdoruesve do t'iu lihet koha e mjaftueshme për reflektimin dhe parashtrimin e opinioneve të tyre.

- Përdoruesit kanë zakonisht një afat kohor prej 6 javësh për të paraqitur opinionin e tyre. Banka gëzon të drejtën e fleksibilitetit për të shkurtuar ose shtrirë në kohë këtë afat duke mbajtur në vëmendje përmbushjen e detyrimeve ligjore, kompleksitetin e konsultimeve apo burimet e disponueshme kundrejt përdoruesve për të paraqitur opinionin e tyre brenda afatit kohor të deklaruar.

1.3.4 Konsultimet me përdoruesit të përshkruara në këtë seksion mund të jenë subjekt i kërkesave ligjore kufizuese në lidhje me qëllimin dhe kohën e procesit të konsultimeve.

1.4 Përdoruesit do të mbahen të informuar mbi zhvillimet në fushën e statistikave të Bankës dhe do të inkurajohen të kontribuojnë në përmirësimin e tyre në të ardhmen.

1.4.1 Përdoruesit brenda Bankës kanë akses të vazhdueshëm në dokumente që përshkruajnë gjetjet e nxjerra nga kërkimet, dhe zhvillimin e strategjive për të ardhmen.

1.4.2 Programi i punës – produkt i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet INSTAT, Bankës dhe Ministrisë së Financave (MF), parashikon zhvillimin e statistikave të reja ose të përmirësuara si pjesë integrale e Statistikave të Llogarive Kombëtare.

- Ky program pune menaxhohet nga grupi drejtues i përfaqësuar nga ekspertë të lartë të INSTAT, MF dhe të Departamentit të Statistikave Financiare.

1.4.3 Përdoruesit e jashtëm mund të aksesojnë në faqen zyrtare të Bankës të gjitha materialet studimore dhe metodologjike që synojnë rritjen e efikasitetit në përdorimin e produkteve statistikore.

1.4.3 Punonjësit e Departamentit të Statistikave Financiare mbajnë korrespondencë të vazhdueshme me punonjësit e AMF-së përsa i përket çështjeve që lidhen me produktet statistikore.

2 Integriteti

Statistikat prodhohen bazuar në metodologji objektive dhe transparente.

Statistikat të cilat nuk ngjallin besim tek publiku dëmtojnë besueshmërinë e politikave vendimmarrëse të mbështetura në këto statistika. Ky seksion përcakton rregullat bazë për krijimin e besimit procedurat dhe praktikat për të maksimizuar aftësinë që ka statistika për të informuar dhe influencuar vendimmarrjen politikëbërëse, si dhe perceptimin publik të këtyre vendimeve.

2.1 Statistikat hartohen në mënyrë të paanshme.

2.1.1 Punonjësi që përgatit raportet statistikore është i mbrojtur nga çdo lloj presioni politik apo të tjera presione të panevojshme që mund të ndikojnë në paraqitjen e statistikave.

- Statistikat e publikuara nga Departamenti i Statistikave Financiare janë të autorizuar nga drejtuesi i Departamentit ose nga drejtuesi i deleguar.
- Statistikat e përgatitura nga njësi të tjera të Bankës janë të autorizuar për t'u shpallur (publikuar) nga drejtuesi i Departamentit përkatës, në konsultim me drejtuesin e Departamentit të Statistikave Financiare.
- Komunikimi i statistikave duhet të bëhet veçmas, në avancë ose në të njëjtën kohë, nga deklaratat politikëbërëse ku produkti statistikor përdoret si referencë.

2.1.2 Deklaratat politikëbërëse ose komentet e Bankës të cilat bëhen në të njëjtën kohë me publikim statistikash, dhe/ose të bazuara në këto statistika, duhet normalisht të përmbajnë një referim ndaj publikimit të statistikave.

2.2 Integriteti i statistikave do të mbështetet nga mirëmbajtja dhe zhvillimi i standardeve të larta të profesionalizmit të punonjësve në çdo nivel.

2.2.1 Kompetenca profesionale do të përsoset nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në trajnime të qenësishme të lidhura me vendin e punës.

- Drejtuesit e njësive në Departamentin e Statistikave Financiare vlerësojnë dhe orientojnë nevojat e trajnimit dhe zhvillimit të punonjësve të përfshirë në përgatitjen e statistikave.

- Programe trajnimi dhe zhvillimi do të promovohen në mënyre aktive.
- Drejtuesit e njësive në Departamentin e Statistikave Financiare inkurajojnë dhe mbështesin punonjësit që synojnë të marrin kualifikime akademike dhe profesionale në çështje të lidhura me cilësinë e punës.

2.2.2 Performanca dhe objektivat e zhvillimit të punonjësve duhet të përcaktohen dhe monitorohen në mënyrë individuale.

2.2.3 Punonjësit nuk do ta shfrytëzojnë përfshirjen e tyre në përgatitjen e statistikave për përfitim personal.

2.2.4 Drejtuesi i Departamentit të Statistikave Financiare duhet të promovojë parimet dhe standardet e këtij Kodi tek punonjësit dhe kolegët që merren me statistika.

- Të gjithë punonjësit e Departamentit të Statistikave Financiare duhet t'i përmbahen këtij Kodi.
- Përdoruesit dhe prodhuesit (e statistikave) në Departamentet e tjera të Bankës duhet të respektojnë detyrimet që rrjedhin nga ky Kod, veçanërisht në lidhje me rregullat për aksesin dhe konfidencialitetin sipas pikave 4.3 dhe 5.3 të këtij Kodi.

2.2.5 Drejtuesi i Departamentit të Statistikave Financiare informohet për çdo pakënaqësi mbi integritetin profesional ose cilësinë e statistikave.

2.2.6 Prodhimi i statistikave në Departamentin e Statistikave Financiare është subjekt i procedurave të Auditimit të brendshëm të Bankës.

2.3 Metodatat dhe praktikatat statistikore duhet të jenë të hapura për publikun.

2.3.1 Metodatat e përdorura në hartimin e statistikave dhe arsyet e përzgjedhjes së tyre, do të publikohen apo do të vihen në dispozicion sipas kërkesës.

- Format e raportimit do të vihen në dispozicion në faqen e internetit të Bankës së bashku me përkufizimet e lidhura dhe me udhëzimet mbi raportimin (shih gjithashtu 6.2 më poshtë).
- Agregatat statistikore të publikuara do të shprehen në mënyrë të qartë.
- Ndryshimet thelbësore në metodologji do të deklarohen përpara publikimit të statistikave të bazuara në metodatat e reja, së bashku me një vlerësim të impaktit të tyre në produktet statistikore të publikuara.

2.3.2 Banka do të verë në dispozicion të përdoruesve një sërë materialesh ndihmëse për interpretimin e statistikave të saj.

- Materiale studimore dhe metodologjike publikohen rregullisht në faqen zyrtare të Bankës.
- Punonjësit e Departamentit të Statistikave Financiare do t'u përgjigjen kërkesave të publikut për informacion në lidhje me statistikat duke ruajtur konfidencialitetin siç është përcaktuar në seksionin 5 të këtij Kodi.

2.3.3 Punonjësit duhet të përfshihen aktivisht në proceset që përmirësojnë njohuritë e publikut mbi statistikat e Bankës dhe çështje statistikore.

- Banka duhet të përgjigjet, brenda mundësive të sqarojë keqkuptime të çështjeve statistikore dhe të zgjidhë keqinterpretime të statistikave të përgatitura nga Departamenti i Statistikave Financiare.

2.4 Integriteti personal i punonjësve garantohet nga zbatimi i standardeve bashkëkohore.

2.4.1 Banka garanton që personeli i saj të respektojë standardet më të larta në punë si edhe në sjelljen e përgjithshme.

- Gjithë punonjësit duhet të respektojnë Kodin e Etikës së Bankës.
- Punonjësit janë të detyruar të shmangin konfliktet e interesit dhe nëse gjejnë që kanë ndonjë interes personal, financiar ose jo, janë të detyruar ta deklarojnë atë tek drejtimi pa humbur kohë.

3 Cilësia

Metodat statistikore do të ndjekin praktikat më të mira ndërkombëtare dhe cilësia do t'i përshtatet qëllimit të produktit statistikor.

Dimensioni i cilësisë së produktit statistikor është shumë i gjerë dhe shtrihet në shumicën e tematikave të shtjelluara në këtë Kod. Gjithsesi, ekziston një kuptim më i ngushtë përmes të cilit përdoruesit vlerësojnë rëndësinë që duhet t'i kushtojnë një vlerë apo një serie të caktuar të dhënash. Në vijim ky seksion shqyrton cilësinë në këtë aspekt të ngushtë, ku më konkretisht ndalet në saktësinë e matjeve të përzgjedhura, në besueshmërinë e vlerësimeve, dhe në shfrytëzimin e statistikave.

3.1 Baza metodologjike për hartimin e statistikave duhet të përshtatet vazhdimisht në përputhje me standardet e pranura ndërkombëtarisht, udhëzimet ose praktikat më të mira.

3.1.1 Hartimi i statistikave do të ndjekë standardet, klasifikimet dhe programet ndërkombëtare, në të gjitha rastet kur këto janë të detyrueshme ose i përshtaten kërkesave të përdoruesve.

- Përkufizimet dhe klasifikimet e pranura ndërkombëtarisht përdoren në të gjitha burimet dhe hartimet statistikore.

3.1.2 Hartimi i statistikave duhet të përdorë përkufizime dhe koncepte që janë të përshtatshme për furnizuesit e të dhënave.

- Të dhënat sipas standardeve të raportimit financiar, do të pranohen për raportim statistikor për atë që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare statistikore dhe/ose diferencat nga këto standarde nuk janë materiale.

3.1.3 Proceset dhe metodat që përdoren në prodhimin e statistikave do të dokumentohen.

- Dokumentimi zhvillohet në mënyrë progresive dhe do të publikohet ose do të jepet sipas kërkesës.
- Dokumentimi do të jetë mjaftueshëm i detajuar në mënyrë që t'i mundësojë përdoruesit të vlerësojë nëse rezultatet e të dhënave i përshtaten qëllimit.

3.2 Cilësia e burimit të të dhënave dhe informacioni i nxjerrë statistikor do të vlerësohen dhe raportohen.

3.2.1 Cilësia e burimit të të dhënave do të mbikëqyret në vazhdimësi.

- Burimi i të dhënave është subjekti i kontrolleve të vlefshmërisë kur është e mundur.
- Burimi i të dhënave vlerësohet për saktësi duke përdorur një seri kontrollesh manuale dhe automatike.

- Paqartësitë e mundshme në lidhje me saktësinë e burimit të të dhënave i komunikohen raportuesit për shpjegime para publikimit.

3.2.2 Procesi tërësor i prodhimit të statistikave do të rishikohet rregullisht me qëllim përmirësimin e cilësisë së produkteve.

- Departamenti i Statistikave Financiare monitoron proceset e hartimit të statistikave dhe raporton rregullisht ecurinë tek Administratorët. Dobësitë e rëndësishme trajtohen në projekte specifike.

3.3 Statistikat do të jenë koherente dhe konsistente.

3.3.1 Statistikat do të vihen në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur pasi të jenë hartuar, ose me shpallje zyrtare ose duke njoftuar që janë të gatshme sipas kërkesës.

3.3.2 Statistikat do të jenë konsistente në tregues, në kohë dhe në të dhënat e lidhura me to.

- Vazhdimësia e informacionit do të sigurohet për të gjitha ndërprerjet e prodhimit statistikor në seritë kohore, kur është e mundur duke pasur parasysh parimin kosto përfitime.

3.4 Rishikimet e të dhënave do të jenë transparente dhe do të udhëhiqen nga një politikë e qartë e aplikuar në mënyrë konsistente përgjatë gjithë procesit të publikimit të statistikave.

3.4.1 Rishikimet do të përfshihen në të dhënat e publikuara në mundësinë më të parë.

- Të dhënat e rishikuara me marrjen e informacionit shtesë ose me korrigjimet apo përmirësimet e të dhënave ekzistuese, përfshihen jo më vonë se në publikimin e ardhshëm të planifikuar të të dhënave.
- Të dhënat e rishikuara që lidhen me përditësimin rutinë të sistemeve të vlerësimit ose metodologjive, gjithashtu, përfshihen në publikimin e radhës në përputhje me kalendarin e rishikimeve.
- Të dhënat e rishikuara lidhur me prezantimin e një ndryshimi material në metodologjinë kryesore të vlerësimit apo përfshirjen e një burimi të ri informacioni, pasqyrohen në publikimin e radhës.
- Rishikime të tilla metodologjike zakonisht aplikohen në seri mbrapa në kohë deri sa është e mundur dhe e përshtatshme.
- Detajet mbi ndryshimet metodologjike, publikohen para ose në të njëjtën kohë me publikimin e të dhënave që mbartin ndryshimin. Ato do të shoqërohen me njoftimin statistikor që ndryshimi metodologjik mund të shkaktojë një shkëputje në seri ose rishikim material të saj.

3.4.2 Rishikimet materiale do të identifikohen në mënyrë të qartë.

- Rregulli i korrektimit të menjëhershëm të të dhënës me marrjen e informacionit të ri mund të shoqërohet me shumë ndryshime të vogla të cilat, në mënyrë individuale, zakonisht mund të përbëjnë pak ose aspak interes për shumicën e përdoruesve
- Njoftimi statistikor identifikon ato rishikime të cilat konsiderohen mjaftueshëm materiale dhe që mund të ndikojnë në interpretimin e të dhënave në fjalë.
- Detajet e kriteret për vlerësimin e materialitetit zakonisht përshkruhen në pjesën e njoftimit statistikor në referencë të rishikimit të caktuar.
- Rishikimet që bien nën pragun e caktuar për materialitetit zakonisht nuk identifikohen

3.4.3 Efektet e rishikimeve në rezultatet kryesore do të monitorohen dhe raportohen.

- Rishikimet mund të ndodhin për shumë arsye dhe prania e tyre në një seri nuk mund të interpretohet si mungesë rigoroziteti në hartimin e statistikave.
- Rishikimet e konsiderueshme janë zakonisht të shoqëruara me një shpjegim mbi natyrën dhe shtrirjen e tyre, dhe janë subjekt i ruajtjes së konfidencialitetit të raportuesit.
- Përdoruesit kanë të drejtën e informimit mbi arsyet e rishikimeve dhe gjasat që vlerësimet aktuale të të dhënave do të jetë subjekt ndryshimi në të ardhmen.
- Historiku i rishikimeve mund t'u vihet në dispozicion përdoruesve me kërkesë.
- Studime mbi rishikime ndërmerren në mënyrë periodike dhe publikohen.

4 Disponueshmëria

Procesi i shpalljes dhe marrëveshjet për disponimin e statistikave të publikuara nga Banka do të jetë i rregullt dhe transparent.

Ky seksion trajton transparencën e praktikave të publikimit, rregullat për të përmbushur nevojat e të gjithë përdoruesve, si dhe marrëveshjet e veçanta për qasje të privilegjuar të parakohshme të të dhënave të caktuara, të cilat përdoren për qëllime të vlerësimit të politikës monetare dhe të stabilitetit financiar.

Marrëdhëniet e veçanta me përdoruesit kanë një rëndësi të veçantë në fushën e publikimeve të bankës qendrore. Banka mban përgjegjësi të plotë për praktikën e saj të para-publikimit. Është e rëndësishme të theksohet se marrëdhëniet e tilla duhet të menaxhohen mirë, sikurse përmendet në seksionin 4.3 më poshtë.

4.1 Marrëveshjet për disponim të produktit statistikor duhet të jenë të hapura dhe të njohura paraprakisht.

4.1.1 Datat e publikimit për të gjitha statistikën shpallen paraprakisht.

- Kalendari i publikimit të statistikave shpallet përpara përfundimit të çdo gjashtëmuajori, dhe mbulon statistikën për periudhën gjashtëmuajore në vazhdim.
- Kalendari i publikimit të statistikave përfshin informacion mbi datën dhe mënyrën e publikimit për publikimin e ardhshëm të këtyre statistikave.
- Departamenti i Statistikave Financiare duhet të sigurojë që kalendari të përfshijë të gjithë produktin statistikor, të saktë dhe sa më të përditësuar. Kalendari duhet të mënjanohet çdo vonesë apo rast mospublikimi për të dhëna rezultati i të cilave gjykohet i pafavorshëm.
- Marrëveshjet për publikimin e të gjitha statistikave zyrtare do jenë publike².
- Çdo ndryshim në produktin statistikor bëhet i njohur paraprakisht në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.
- Statistikat publikohen në orën 10.00, përveç rasteve kur ka argumente bindëse për të kundërtën.
- Në kohën e publikimit të statistikave, punonjësit përgjegjës duhet të jenë të disponueshëm për të ofruar këshilla dhe sqarime dhe për të siguruar që procesi i publikimit përfundon në mënyrë korrekte.

² Programi i statistikave zyrtare.

4.2 Praktikrat e publikimit do të promovojnë barazinë e aksesit në statistika.

4.2.1 Statistikat do të jenë në dispozicion për të gjithë përdoruesit në të njëjtën kohë, me përjashtim të rasteve të parapara në seksionin 4.3 të këtij Kodi.

- Publikimi i statistikave bëhet nëpërmjet internetit pasi ai ofron mjetin më efektiv për të lehtësuar shpërndarjen e njëkohshme për gamën më të gjerë të përdoruesve aktualë dhe potencialë.
- Pas orës 10.00 monitorohet disponueshmëria e të dhënave dhe çdo vonesë materiale do të evidentohet.

4.2.2 Statistikat do të publikohen në formë të përshtatshme për përdoruesit.

- Formatet, përmbajtja dhe materialet mbështetëse rishikohen rregullisht, për të përmbushur nevojat e të gjithë përdoruesve.
- Në faqen e internetit të Bankës duhet të publikohet një informacion i pasur statistikor dhe mbështetës.
- Formatet e publikimeve të statistikave të prodhuara nga Banka janë subjekt i rishikimeve të rregullta.
- Të dhëna statistikore që dërgohen drejtpërdrejt në Instat janë të përshtatura për të përmbushur nevojat specifike të tij, për hartimin e llogarive kombëtare, PBB dhe të tjerë tregues sipas marrëveshjeve institucionale.
- Për organizata të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare të angazhuara në hartimin dhe/ose shpërndarjen e statistikave monetare dhe financiare, statistikat dërgohen drejtpërdrejt.

4.3 Disponimi i privilegjuar/parakohshëm i produktit statistikor të Bankës do të kontrollohet me rigorozitet dhe marrëveshjet specifike për çdo rast do të jenë transparente.

4.3.1 Disponimi i parakohshëm i statistikave mund të jepet për punonjësit e Bankës të përfshirë në formulimin e politikës monetare, në vlerësimin e stabilitetit financiar dhe në mbikëqyrjen e institucioneve financiare.

- Përdoruesit i jepet akses i parakohshëm në rastet kur mosdhënia e këtij aksesit pengon në mënyrë të konsiderueshme dhënien e deklaratave ose ndërmarrjen e veprimeve në ose rreth kohës së publikimit.
- Dhënia e parakohshme e statistikave kufizohet në numrin minimal të përdoruesve që kanë nevojë pune.
- Dhënia e parakohshme e statistikave mund të bëhet për Guvernatorin dhe Drejtues të Bankës, dhe punonjësve në njësinë e publikimit, të cilët përgjigjen për publikimin.
- Për përdoruesit e Bankës të cilët nuk janë drejtpërdrejt të përfshirë në hartimin e statistikave, aksesit i parakohshëm në to duhet të jetë i autorizuar nga drejtuesi i Departamentit të Statistikave Financiare.

4.3.2 Kushtet që aplikohen për dhënien e parakohshme të statistikave janë si më poshtë:

- Përfituesve u kërkohet të zbatojnë rregullat për përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënave.
- Të dhënat duhet të kenë shënimin “konfidencial”.

4.4 Dhënia e parakohshme e të dhënave jashtë Bankës.

4.4.1 Statistikat në formën e tyre përfundimtare mund t'i jepen paraprakisht Ministrisë së Financave, për të maksimizuar dobinë e të dhënave për hartuesit e politikave dhe për ata që përgatisin analiza mbështetëse.

- Përdoruesit i jepet akses i parakohshëm në rastet kur mosdhënia e këtij aksesit pengon në mënyrë të konsiderueshme dhënien e deklaratave ose ndërmarrjen e veprimeve në ose rreth kohës së publikimit.
- Dhënia e parakohshme e statistikave kufizohet në numrin minimal të përdoruesve, konsistente me nevojën për t'i pasur ato.
- Dhënia e parakohshme e të dhënave bëhet deri në një ditë pune para publikimit, por mund të jetë më vonë se ky afat, nëse vonohet finalizimi i të dhënave.
- Çdo ndryshim në statistika që ndodh pas dhënies së tyre të parakohshme, por para publikimit, do të rezultojë vetëm nga korrigjimet ose, në rrethana të jashtëzakonshme, nga informacion shtesë nga burimi.
- Të gjitha marrëveshjet për akses të parakohshëm në statistika për personin/at përgjegjës në Ministrinë e Financave janë të autorizuar nga Administratori në varësi.
- Përdoruesve jashtë Bankës u kërkohet të zbatojnë rregullat për përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënave.

4.5 Publikimi i paautorizuar

4.5.1 Në rast të publikimit të paautorizuar të statistikave përpara datës zyrtare të publikimit, Banka do të kryejë një investigim për të përcaktuar rrethanat e publikimit. Të gjithë ata që përfitojnë nga aksesit i parakohshëm ose paraprak mund të kërkohet të japin llogari për trajtimin dhe përdorimin e të dhënave.

5 Konfidencialiteti

Shumë prej statistikave të hartuara nga Banka rrjedhin nga informacione sensitive tregtare të njësive individuale (institucion ose person fizik, juridik dhe familje). Ky seksion përshkruan vendosjen e udhëzuesve dhe protokolleve (rregulloreve) mbi mënyrën e disponimit të informacionit, prodhimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore, me synim parandalimin e zbulimit të paqëllimshëm të të dhënave individuale të njësive raportuese.

Konfidencialiteti statistikor është përcaktuar në dokumente të ndryshme ligjore dhe rregullatore. Një pjesë janë përcaktuar nga dispozitat në aktet ligjore (ligji 9180, datë 5.2.2004, ndryshuar me ligjin nr. 21/2012, ndryshuar me ligjin nr. 7/2013, "Për Statistikat Zyrtare", Neni 15; ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"), por gjenden edhe në Kodin e Etikës së punonjësve, në rregulloret dhe procedurat mbi politikën e mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së treguesve statistikorë.

5.1 Punonjësit e përfshirë në mbledhjen, përpunimin dhe prodhimin e statistikave, nënshkruajnë një deklaratë mbi ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënës, ku të marrin parasysh kufizimet e kuadrin ligjor të sipërpërmendur dhe duhet të jenë të vetëdijshëm mbi penalitetet e mundshme që aplikohen për moszbatimin ose shkeljen e kërkesave të konfidencialitetit.

5.1.1 Çdo vit, personeli do të jetë i detyruar të nënshkruajnë deklaratën mbi ruajtjen e konfidencialitetit.

5.1.2 Të gjithë punonjësit, të cilët kanë akses në të dhëna të bizneseve individuale gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

5.2 Njësitë raportuese do të informohen rregullisht mbi përdorimet e të dhënave të tyre. Ato duhet të garantohen se disponimi mbi informacionin do të jetë i kufizuar, vetëm për qëllime statistikore, studimore dhe rregullatore dhe në asnjë rast nuk do t'i vihet në dispozicion palëve të treta qofshin këto institucione publike apo entitete private të natyrave të ndryshme.

5.2.1 Njësia raportuese do të informohet për të drejtat dhe detyrimet e saj në lidhje me dhënien e informacionit.

5.2.2 Të gjitha të dhënat individuale të mbledhura nga njësia statistikore për prodhimin e statistikave do të përdoren vetëm për qëllime statistikore. Këto të dhëna do të botohen vetëm të grupuara dhe nuk do të përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, duke përfshirë këtu vendime për kontrollin fiskal ose hetime juridike.

5.3 Procedurat, rregulloret dhe udhëzimet specifike do të administrojnë rrezikun e shkeljeve të konfidencialitetit statistikor në proceset e prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave.

5.3.1 Departamenti i Statistikave Financiare do të marrë të gjitha masat e duhura teknike, teknologjike dhe organizative në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen nga çdo hyrje, identifikim ose përdorim i paligjshëm i të dhënave konfidenciale.

5.3.2 Drejtuesi i Departamentit të Statistikave Financiare do të jetë përgjegjës për garantimin e vendosjes së kontrolleve, për të siguruar që procedurat e vendosura për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave të njësive statistikore janë kryer konform rregulloreve dhe udhëzimeve.

5.3.3 Raportuesit individualë nuk do të jenë të identifikueshëm drejtpërdrejt ose tërthorazi në statistikat e publikuara.

- Çdo statistikë që vlerësohet me të dhëna reale ose të vlerësuara, në publikim do të përfshijë në total të paktën tri njësi dhe pjesa e një njësie nuk do të kalojë 85 për qind të totalit.
- Nëse të dhënat e agreguara në grupe dhe nën-grupe mund të identifikojnë në mënyrë të tërthortë një njësi statistikore, p.sh. ndërmjet diferencës midis dy nëngrupeve, të dhënat do të rigrupohen menjëherë, në mënyrë që njësia raportuese të mos jetë më e identifikueshme.
- Nëse një seri është e dominuar vazhdimisht nga tre njësi raportuese, atëherë publikimi i vazhdueshëm i kësaj serie mund të rishikohet.

5.3.4 Të dhënat e nxjerra nga burimet e disponueshme publikisht nuk do të vlerësohen si konfidenciale.

5.4 Të dhënat e raportuara që identifikojnë njësi statistikore individuale do të kenë mbrojtje të sigurt nga Banka.

5.4.1 Sistemet për mbledhjen, ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave brenda Bankës do të jenë konform standardeve më të mira ndërkombëtare. Ato duhet të garantojnë siguri të lartë në mbrojtjen e integritetit të të dhënave nga akseset e padëshiruara. Ato do të jenë subjekt i vazhdueshëm përditësimi në përputhje me zhvillimet në teknologjinë e informacionit dhe në atë të përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave.

6 Barra në raportim

Ngarkesa në raportim do të mbahet në një nivel të pranueshëm në përputhje me kërkesat ligjore dhe duke balancuar nevojat e përdoruesve kundrejt kërkesave për raportim statistikor. Monitorimi i ngarkesës së raportimit dhe vendosja e objektivave për reduktimin e saj do të kryhet në mënyrë periodike.

Ky seksion i Kodit analizon procedurat për vlerësimin e ngarkesës me të cilën përballen raportuesit nga kërkesat e Bankës për informacion statistikor. Qëllim kryesor është shmangia e kërkesave të pajustificuara apo të dobëta gjatë procesit të mbledhjes së informacionit statistikor. Drejtuesi i Departamenti të Statistikave siguron që mbledhja e të dhënave ekzistuese ose të dhënat e reja plotësojnë kriteret rigorozë të pranimit.

Parimet kryesore të grumbullimit të të dhënave janë si më poshtë:

- Të dhënat statistikore dhe rregullatore grumbullohen për qëllimin e kërkuar, bazuar në parimet kosto – përfitim.
- Metodatat e mbledhjes së të dhënave do të synojnë garantimin që të dhënat të kërkojnë vetëm një herë.

6.1 Kostot, në kohë dhe në vlerë, që shkaktohen nga kërkesat e Bankës për raportimin e të dhënave, do të jenë në përputhje me kërkesat ligjore për prodhimin e statistikave.

6.1.1 Departamenti i Statistikave Financiare do të përdorë burimet ekzistuese të të dhënave dhe/ose teknika vlerësimi dhe në çdo moment të dhënat do të mblidhen për qëllimin e kërkuar, bazuar në parimin kosto – përfitim.

- Departamenti i Statistikave Financiare konsideron përdorimin e burimeve ekzistuese (forma raportimi ekzistuese nga burime administrative, rregulloret ekzistuese) përpara se të ndërmerret një burim i ri të dhënash (formë e re raportimi ose rishikimi i një forme ekzistuese).
- Në varësi të kërkesave për informacion shtesë do të merret parasysh edhe monitorimi i barrës së raportimit dhe reduktimi i tij kur është e mundur. Kujdes do të bëhet për shmangien e dublimeve të mundshme.
- Banka do të përdorë të dhëna administrative të ruajtura në regjistra publikë për prodhimin e statistikave.
- Metodatat e përdorura për mbledhjen e të dhënave do të garantojnë se raportimi për të njëjtat të dhëna do të kërkojë vetëm një herë.

6.1.2 Ndryshimet e një forme raportimi ose sistemit ekzistues të mbledhjes së të dhënave, si rezultat i kërkesave të reja statistikore do të bëhet duke analizuar edhe koston në barrën e raportimit për njësitë raportuese që ofrojnë të dhëna kundrejt përfitimeve të mundshme.

- Aplikimi i formave të reja të raportimit, ndryshime të rëndësishme në format ekzistuese ose ndërprerja e formave ekzistuese, do të aprovohet nga Administratori në varësi me propozim të Drejtorit.
- Miratimi kërkon një relacion me shkrim që përcakton kërkesat e reja statistikore për të cilat do mblidhet informacioni, një vlerësim të kostove dhe përfitimeve mbi ndryshimet e propozuara në format e reja të mbledhjes së të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në reduktimin e barrës së raportimit.

- Pas paraqitjes së formatit të ri të mbledhjes së të dhënave, ose rishikimit të Statistikave Financiare atyre ekzistuese, Departamenti i Statistikave Financiare do të shmangë kryerjen e ndryshimeve të tjera të paktën për pesë vitet e ardhshme, në varësi kjo të ndonjë kërkesë statistikore të kërkuar me ligj.
- Dihet gjithashtu se do të ketë kërkesa të dhënash rastësore dhe të parregullta *ad hoc* që do të duhet të veprohet nën marrëveshje më fleksibile.

6.1.3 Format ekzistuese të raportimit mund të rishikohen çdo pesë vjet, duke përdorur teknikat e kosto – përfitimeve, e cila garanton se sistemi i mbledhjes së të dhënave është ende i nevojshëm dhe është më i përshtatshmi referuar termave kosto-përfitim nga burimet e tjera.

6.1.4 Format e raportimit do të jenë të qarta dhe të kuptueshme.

6.1.5 Sistemi i raportimit për mbledhjen e të dhënave statistikore do të reduktohet në minimumin e mundshëm të nevojshëm për prodhimin e statistikave dhe duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë dhe cilësinë e rezultatit të kërkuar.

6.1.6 Përgjigjet e njësive raportuese me cilësi të dobët ose të raportuara me vonesë në kohë do të ndiqen në mënyrë rigoroze për të garantuar se barra në raportim është shpërndarë në mënyrë të drejtë.

6.2 Kërkesat e njësive raportuese do të trajtohen si pjesë integrale e procesit të prodhimit të të dhënave statistikore dhe rregullative.

6.2.1 Raportuesit e të dhënave do të informohen për qëllimin dhe synimin e raportimit të të dhënave, përdorimet dhe rëndësinë e statistikave të prodhuara dhe rëndësinë e të dhënave që do të raportohen prej tyre.

6.2.2 Raportuesit (njësitë statistikore) e të dhënave do të përfshihen në konsultime mbi projektet e reja të mbledhjes dhe zbatimit të të dhënave përpara se të merren vendimet përkatëse.

- Paraprakisht, Banka sigurohet se raportuesi disponon informacionin e të dhënave që duhet të raportojë, për të siguruar të dhëna të sakta.
- Vendosja e të dhënave bëhet në bashkëpunim me raportuesit, ato duhet të jenë realiste dhe të harmonizuara me databazën që ata disponojnë në sistemet e tyre financiare.
- Format e raportimit do të publikohen në faqen e internetit të Bankës.

6.2.3 Raportuesit do të kenë asistencë të vazhdueshme teknike në përmbushjen me cilësi të procesit të raportimit të të dhënave.

- Përshkrime metodologjike dhe udhëzime të detajuara mbi raportimet do të jenë në dispozicion të raportuesve.
- Njësitë statistikore do të jenë të pajisura me një numër kontakti për të ofruar sqarime dhe këshilla teknike sipas nevojës së raportuesve.
- Metodologjia e raportimit është në dispozicion të publikut në faqen e internetit të Bankës.
- Departamenti i Statistikave Financiare kryen periodikisht seminare mbi kërkesat e të dhënave për punonjësit e institucioneve raportuese me përgjegjësi për raportimin statistikor dhe rregullativ.

7 Efektiviteti i shpenzimeve

Statistikat do të prodhohen në mënyrë efektive.

Parimet e përshkruara në këtë Kod, evidentojnë funksionin e rëndësishëm të Bankës për të mbledhur, për të përgatitur dhe për të shpërndarë statistika në kohë, me vërtetësi dhe në mënyrë efikase. Ky seksion i fundit konsideron masat në drejtim të rritjes së efektivitetit.

7.1 Struktura e Departamentit të Statistikave Financiare dhe angazhimet e menaxhimit përta i përket bazës rregullative statistikore do të jenë në përputhje me funksionet e Bankës.

7.1.1 Struktura organizative e Departamentit të Statistikave Financiare do të jetë e disponueshme për të gjithë.

7.1.2 Përshtatshmëria e strukturës organizative dhe angazhimet e menaxhimit të bazës së të dhënave statistikore do të jenë në mënyrë të vazhdueshme në procesin e kontrollit dhe rishikimit.

7.2 Departamenti i Statistikave Financiare do të synojë vendosjen e objektivave realistë për matjen e performancës në të gjitha nivelet.

7.2.1 Objektiva individuale të performancës do t'u caktohen të gjithë punonjësve të njësisë së Departamentit të Statistikave Financiare.

7.2.2 Projektet e zhvillimit, qofshin ato të natyrës investim kapital apo kërkimor, do të administrohen në mënyrë efektive si edhe do të jenë subjekt vlerësimi në kuadër të objektivave të dakordësuara më parë.

7.2.3 Drejtuesi i Departamentit të Statistikave Financiare në bashkëpunim me Administratorin në varësi do të përcaktojë objektivat vjetorë të performancës për Departamentin e Statistikave, të cilat janë subjekt rishikimi dhe vlerësimi.

7.3 Përshtypjet e përdoruesve mbi vlerësimin e ecurisë do të inkurajohen në mënyrë të vazhdueshme.

7.3.1 Departamenti i Statistikave Financiare do të ndërmarrë anketa periodike përta i përket përmbushjes së kërkesave të përdoruesve në kuadër të nivelit të shërbimit, cilësisë së informacionit si edhe strukturës dhe afatet kohore të produkteve statistikore.

7.4 Statistikat e prodhuara iu ofrohen të gjithë përdoruesve, pa pagesë.

7.4.1 Banka nuk do të bëjë asnjë përpjekje për të mbuluar kosto të cilat lidhen me grumbullimin dhe hartimin e informacionit statistikor të publikuar, nëpërmjet pagesave të drejtpërdrejta.

- Metoda parësore e transmetimit të informacionit statistikor është interneti.
- Informacioni statistikor në faqen zyrtare të Bankës është i aksesueshëm dhe shkarkohet pa pagesë.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës

Gent SEJKO